




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Kandidatët pjesëmarrës për aplikim për licencë të KPM-së, në bazë të konkursit të shpallur më 27 shtator 2019, për Komunën e Gjakovës:

**Kandidati:** "Criteria Network" SH.P.K.

**Nr. unik identifikues:** 810848062

**Përfaqësuar nga:** Blerim Kroma

**Emri i propozuar:** Radio Criteria

**Adresa:** Rr/Mati 1, Lin Projekt, Hyrja 8, Nr.41  
Prishtinë

**Kodi i kandidatit:** R1

Ref: 1912/1443/LIC/ni

## VENDIM

për licencimin e kandidatit R1 për transmetim të radio programeve, me mbulim që i përket kategorisë lokale në Komunën e Gjakovës

### Fakte

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio dhe audiovizuale.
2. Në bazë të Ligjit nr. 04/L-44 (Ligji për KPM), neni 3, paragrafi 2.1, KPM licencën transmetuesit publik e privat dhe i ripërtërin licencat, duke iu dhënë subjekteve të autorizuar të drejtën e përdorimit të frekuencave në Spektrin e Frekuencave të Transmetimit si dhe licencën të gjitha shërbimet mediale audiovizuale.
3. Neni 3, paragrafi 2.6, i Ligjit për KPM-në, i jep kompetencë dhe e obligon KPM-në që të nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat shërbejnë për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
4. Në pajtim me nenin 23, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në, më 27 shtator 2019, KPM-ja ka shpallur konkurs publik për dhënien e licencave të reja për transmetim lokal të radio programeve në Komunën e Gjakovës. Konkursi ka qenë i hapur nga data 27 shtator 2019



deri më datën 27 tetor 2019, ora 16:00, ndërsa më datën 25 tetor 2019, KPM-ja ka marrë vendim për zgjatjen e afatit të konkursit deri më datën 8 nëntor 2019, ora 16:00.

5. Konkursi publik është zhvilluar mbi bazën e Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, të nevojshme për plotësimin dhe parashtrimin e aplikimit për licencë të KPM-së që janë:
  - Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (KPM-2017/02);
  - Rregullorja për vlerësimin e aplikacioneve (KPM-2014/02); dhe
  - Rregullorja për Tarifën Vjetore për Licencë (KPM-2017/06).
6. Kandidati R1 ka dorëzuar aplikacionin e kompletuar në KPM, brenda afatit dhe në pajtim me konkursin publik.
7. Kandidati R1 ka qenë i vetmi kandidat i cili ka aplikuar për licencë të radios në konkursin publik për Komunë e Gjakovës.

### Arsyetim

8. Vendimi i KPM-së për dhënien e licencave të reja është bërë mbi bazën e nevojave të publikut dhe kapaciteteve të lira frekuencore në ato komuna të Republikës së Kosovës, ku është vlerësuar se ka mungesë të shërbimeve mediale radio me mbulim lokal dhe regional, si dhe në ato komuna ku është kërkuar që të krijohet mundësi për pluralizëm medial.
9. Neni 21, paragrafi 1, i Ligjit për KPM-në, thekson se: *“Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
10. Neni 22, paragrafi 4, pikat: 4.1, 4.2, 4.3, 4.4 dhe 4.5, të Ligjit për KPM-në, përcakton kriteret kryesore mbi bazën e të cilave KPM-ja vlerëson aplikacionet e kandidatëve për dhënien e licencës së KPM-së.
11. Komisioni konstatuar se aplikacioni i kandidatit R1 është dorëzuar i kompletuar në KPM dhe në pajtim me Rregulloren KPM-2017/02, duke i plotësuar në tërësi kushtet kualifikuese për licencë të KPM-së.
12. Komisioni për Vlerësim të Aplikacioneve konstaton se kandidati R1 ka parashtruar aplikacionin e tij për licencë të radios në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së si dhe në bazë të dokumentacionit të përgjithshëm të konkursit publik, duke plotësuar kushtet dhe kriteret për tu pajisur me licencë të KPM-së për të ofruar radio programe me interes për publikun.

### Vendim

13. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më 24 dhjetor 2019 merr vendim që Kandidatit R-1 - Radio CRITERIA t'ia APROVOJË kërkesën për licencë të KPM-së, mbi bazën e

